REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 01
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No 05-8149
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -5-
Data: / Datum: / Date: 17/11/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Ministe

Nr.250/XI/2026
Datë:16.11.2026

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 16, 17, 18 të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr.02/2026 për Shkollimin Specialistik, në bazë të propozimit të Bordit për Shkollim Specialistik nr. prot. 05-7985, datë 11/11/2026, nxjerr:

V E N D I M

I. Shpallet konkursi publik për shkollim specialistik në këto Komuna: Klinë, Kaqanik, Skendëraj, Prizren dhe Shtërpc si dhe Departamentin shëndetësor të burxheve në Ministrinë e Shëndetësisë.

II. Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidantët e intresuar që i plotësojn kriteret e konkursit.

III. Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike, përmes platformës online https://specializimet.rks-gov.net/.

IV. Aplikimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e publikimit të konkursit në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.

V. Gjatë aplikimit, çdo kandidat ka të drejtë të përzgjedhë vetëm një lëmi specialistike dhe kategori nga lista e specializimeve të ofruara, në përputhje me profilin e tij profesional.

VI. Lëmit specialistike, Kriteret e konkursit, Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për shkollim specialistik janë të përcaktuara në shtojcë të këtij Vendimi;

VII. Obligohet Divizioni i Komunikimit me Publikun të publikoj Konkursin në web faqen zyrtare të Ministrisë së shëndetësisë;

VIII. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Vitia

Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- *Zëvendësministrit;*
- *Ud Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamenti ligjor;*
- *Bordit për shkollim specialistik;*
- *Drejtorit të SHSKUK-së;*
- *Drejtorive komunale përkatëse;*
- *Departamentit shëndetësor të burxheve;*
- *Arkivit të MSh:*

Kategoria I: Lëmit specialistike për nivelin parësor shëndetësor.

Lëmia specialistike	**Titulli paraprak**	**Institucioni**	**Numri i vendeve**
Mjekësi familjare	MD	QKMF	Total, sipas shpërndarjes komunale: Klinë: 7 Kaçanik: 2 Skënderaj: 5 Prizren: 15 Shtërpcë: 1
Radiologji	MD	QKMF	Total, sipas shpërndarjes komunale: Kaçanik: 1 Skënderaj: 1
Gjinekologji me obstetrike	MD	QKMF	Total, sipas shpërndarjes komunale: Kaçanik: 1 Skënderaj: 1
Pediatri	MD	QKMF	Total, sipas shpërndarjes komunale: Skënderaj: 1
Pedodonci me Stomatologji Preventive	DrDent	QKMF	Total, sipas shpërndarjes komunale: Klinë: 1 Skënderaj: 1

Kategoria II: Lëmit specialistike në kuadër të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve.

Lëmia specialistike	**Titulli paraprak**	**Institucioni**	**Numri i vendeve**
Psikologji Klinike	Psikolog klinik i licencuar	Departamenti Shëndetësor i Burgjeve	Total: 1
Psikiatri	MD	Departamenti Shëndetësor i Burgjeve	Total: 1
ORL	MD	Departamenti Shëndetësor i Burgjeve	Total: 1

1) Kriteret e konkursit publik për specializantë:

A. Nota mesatare gjatë kohës së studimeve, 50 pikë:
Llogaritja e pikëve bëhet sipas formulës 5 x nota mesatare;

B. Koha e pritjes pas diplomimit, 15 pikë:

1 vit pritje ekuivalente me 1 pikë, 1 muaj i plotë pritje është ekuivalent me 1/12 e pikës,
Minimumi i pikëve 5,
Maksimumi i pikëve 15

C. Përvoja e punës,

15 pikë: 1-5 vite 10 pikë,
Mbi 5 vite deri 10 vite 12.5 pikë,
Mbi 10 vite 15 pikë

D. Koha e kryrjes së studimeve, 10 pikë:

Vonesa llogaritet sipas formulës 10 minus x pikë,
1 vit vonesë është ekuivalent me 1 pikë,
1 muaj i plotë vonesë është ekuivalent me 1/12 e pikës,

Minimumi i pikëve 5

E. Kriteret tjera, 10 pikë:

-E1. Publikimet shkencore në Web of Science/Scopus në cilësi të autorit të parë, deri në 5 pikë, --1 publikim shkencor në cilësi të autorit të parë 2.5 pikë

-E2. Pjesëmarrja aktive në cilësi të autorit të parë në konferencat e listuara në Web of Science/Scopus, deri në 3 pikë,

--1 pjesëmarrje aktive në cilësi të autorit të parë në konferencë 1.5 pikë

F. PhD e përfunduar (në lëmitë mjekësore për doktorët e mjekësisë, në lëmitë stomatologjike për doktorët e stomatologjisë, në lëmitë farmaceutike për magjistrat e farmacisë dhe në lëmitë ekuivalente për psikologët klinikë) deri në 2 pikë,

-Master shkencor i përfunduar (në lëmitë mjekësore për doktorët e mjekësisë, në lëmitë stomatologjike për doktorët e stomatologjisë, në lëmitë farmaceutike për magjistrat e farmacisë dhe në lëmitë ekuivalente për psikologët klinikë) deri 1 pikë.

G. Pikët negative

1. Specializimi paraprak -20/100 pikë, sipas sistemit -20 pikë specializim i përfunduar ose i pa përfunduar/pezulluar/ndërprerë (përjashtim bëjnë specializantët të cilët e kanë të çregjistruar specializimin dhe kanë kryer obligimet kontraktuale me Ministrine e shëndetësisë apo Institucionin shëndetësor, ose ata të cilët e kanë bërë për arsye shëndetësore të dokumentuar me mendim konziliar).

2.Tërheqja pa arsye nga konkursi paraprak (refuzimi i specializimit të fiuar) pas daljes së rezultateve përfundimtare, në fazën e paraparë për lidhjen e kontratës - 10/100 pikë.

Të drejtën e konkurimit për specializim e kanë aplikantet, në vijim:

Të drejtën e konkurimit për specializim e kanë të gjithë shtetasit e Kosovës që kanë mbaruar studimet universitare në profilet e profesioneve shëndetësore,

1. Të ketë përfunduar studimet universitare (nivelin bachelor dhe master, ose studimet e integruara që përfshijnë këto dy nivele) në një nga drejtimet: Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji.

2. Për specializimet nga psikologjia klinike duhet të kenë mbaruar masterin e psikologjisë ose nivel të shkollimit të barasvlefshëm me nivelin master në fushën e psikologjisë klinike, psikologjisë së këshillimit, psikologjisë së përgjithshme dhe neuropsikologjisë;

3. Të ketë licencë valide të punës nga fusha profesionale përkatese;

4. Të kenë certifikatë për aftësi të domosdoshme psiko-fizike për vijimin e shkollimit specialistik;

5. Për specializimet në lëmitë kirurgjikale kandidatët duhet të kenë dëshmi se në kohën e aplikimit nuk kanë më shumë se katërdhjetë (40) vjet;

6. Të jetë anëtar i Odës përkatëse të Profesionistëve Shëndetësor.

7. Për kategoritë II dhe III, duhet të ketë kontratë pune valide dhe rekomandim me shkrim nga institucioni kërkues, i cili zotohet me shkrim se do ta mbështesë financiarisht shkollimin specialistik të aplikantit.

2.Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për shkollim specialistik:

1. Kopje e noterizuar e diplomës të studimeve universitare (niveli bachelor dhe master ose studimet e integruara që perfshijnë këto dy nivele) dhe certifikata e nostrifikimit të Diplomës (për ata që kanë diplomuar jashtë Kosoves) në drejtimet: Mjekësi e Pergjithshme, Stomatologji, Psikologji Klinike;

2. Certifikata e notave me kalkulim të notës mesatare (nëse kjo nuk figuron në Diplomë), ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet vërtetim i barasvlerësimit të notës mesatare në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";

3. Kopje e noterizuar e licencës valide të punës në fushën profesionale përkatëse;

4. Certifikata mjekësore e aftësisë psiko-fizike;

5. Kopja e letërnjoftimit;

6. Vërtetim anëtarësie nga Oda përkatëse e Profesionistëve Shëndetësor;

7. Vërtetim për përvojën e punës në fushën profesionale përkatëse, të fituar pas licencimit, në të cilin specifikohen detyrat e punës, së bashku me pasqyrën e Trustit.

8. Deklaratë nën betim në lidhje me nje specializim paraprak (të filluar, të përfunduar, të ndërprerë ose të refuzuar) e plotësuar dhe e nënshkruar personalisht nga aplikanti (mund të shkarkohet në vegzën konkursit);

9. Për kategoritë I dhe II: Kontratë pune valide; Rekomandim me shkrim nga institucioni kërkues, në të cilin institucioni zotohet se do ta mbështesë financiarisht shkollimin specialistik të aplikantit.

VËREJTJE:

Nuk pranohen publikimet shkencore në revistat të cilat në vitin e publikimit janë të vlerësuara në kategorinë 0 ose nuk janë fare të kategorizuara sipas regjistrit norvegjez të revistave shkencore, ndërsa nëse viti i publikimit nuk është i disponueshëm në regjistër atëherë llogaritet viti më i fundit i vlerësimit (https://kanalregister.hkdir.no/en/sok?option=journals&input=life&page=1).